

ndihmon në reduktimin e kohës së nevojshme që bankave u nevojitet për marrjen e vendimit për dhënien e kredive dhe ndikon në rritjen e cilësisë së kredisë. Gjithashtu, kredidhënësit përfitojnë nga ulja e kostove të kredive dhe si rezultat, kanë në dispozicion më shumë fonde të vlefshme për kredi.

6. Përfitimet e kredimarrësve nga Regjistri i Kredive

Raporti personal i kreditit është një pasqyrë e "shëndetit financiar" të individëve dhe bizneseve. Nëse Regjistri i Kredive reflekton një historik pozitiv krediti të dikujt, domethënë nëse kredimarrësi ka qenë i rregullt në shlyerjen e kredive të mëparshme, kur ai kërkon kredi nga burimi i tij financiar, përfiton shërbime më të shpejta dhe me interesa më të ulëta. Norma më të ulëta të interesit për një aplikues të caktuar vijnë si rezultat i rrezikut më të ulët të kreditimit që ai përfaqëson, krahasuar me dikë që është vazhdimisht me vonesë në shlyerjen e detyrimeve të tija financiare.

Banka e Shqipërisë



Regjistri i Kredive



Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej" Nr.1
Tiranë, Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 10000 kopje

REGJISTRI I KREDIVE

Çfarë është Regjistri i Kredive?

Regjistri i Kredive është një bazë me të dhëna dhe informacione demografike dhe mbi angazhimet financiare, reale të personave që aplikojnë për kredi pranë një banke, dege të një banke të huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë apo pranë institucioneve të tjera kredidhënëse. Qëllimi kryesor i Regjistrit të Kredive është të ndihmojë në kryerjen e transaksioneve të shëndosha kredituese, nëpërmjet vënies në dispozicion të informacionit mbi kredimarrësit, si dhe nxitjes së eficiencës dhe sigurisë së procesit të kredidhënies.

1. Përse shërben Regjistri i Kredive?

Duke shërbyer si depozitues të dhënash mbi kredimarrësit, Regjistri i Kredive mundëson dhënien e informacionit të detajuar bankave ose institucioneve të tjera kredidhënëse dhe i ndihmon ato të marrin vendime më të mira në lidhje me kredidhënien. Në sajë të këtij regjistri, çdo bankë apo institucion tjetër kredidhënës është në gjendje të vlerësojë më mirë klientët, bazuar në aftësitë e tyre për të shlyer detyrime financiare, garancitë dhe besueshmërinë e tyre.

Gjithashtu, regjistri ndikon në uljen e informalitetit në ekonomi, në rritjen e vëllimit të kredive, duke reduktuar koston dhe kohën e procesit të kreditimit, si edhe në rritjen ekonomike të vendit.

2. Pjesëmarrësit dhe funksionimi i Regjistrit të Kredive

Në mbledhjen dhe përditësimin e informacioneve të Regjistrit të Kredive, marrin pjesë të gjitha bankat apo institucionet e tjera kredidhënëse, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Në momentin e paraqitjes së një kërkesë për kredi, bankat përdorin informacionin e Regjistrit të Kredive për të verifikuar besueshmërinë dhe nivelin aktual të kreditimit të klientit të mundshëm, për ta financuar ose jo atë, si dhe për të përcaktuar kushtet e shlyerjes së kredisë.

Regjistri i Kredive nuk merr vendime për kreditë dhe as nuk jep kredi për huamarrësit. Ai vetëm grumbullon të dhëna, i sistemon ato në bazën e të dhënave, si dhe rinxjerr informacionin demografik dhe të kreditit mbi aplikuesit për kredi, kur i kërkohet një gjë e tillë nga përdoruesit e autorizuar.

3. Informacioni që përmban Regjistri i Kredive

Regjistri i Kredive përmban dy lloje kryesore informacioni:

a) Të dhëna personale dhe demografike të nevojshme për identifikimin e personit, si për shembull emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, adresa e banimit dhe numri i një dokumenti

identifikimi.

b) Informacione mbi historikun e kreditimit të klientit, si për shembull banka/t kredituese, lloji i kredisë, shuma e kredituar, shuma e humbjeve të mundshme, lloji i valutës etj..

4. Përdorimi dhe marrja e informacionit

Përdorimi i informacionit të raportit personal të kreditit kufizohet vetëm për qëllim të vlerësimit të kredimarrësit, kur bëhet një aplikim për kredi nga ana e klientit. Kjo do të thotë se të dhënat personale nuk mund të përdoren për qëllime marketingu apo reklamimi, dhe se ato nuk i jepen palëve të treta të paautorizuara.

Çdo person, rreth të cilit mbahet informacion dhe të dhëna në Regjistrin e Kredive, ka të drejtë që përkundrejt një pagese të arsyeshme, të informohet në rrugë zyrtare në lidhje me këtë informacion. Mjafton që t'i drejtohet Regjistrit të Kredive me një kërkesë me shkrim dhe brenda 10 ditësh nga depozitimi i kërkesës, personi do të pajiset me një kopje të informacionit të kërkuar.

5. Përfitimet e bankave nga Regjistri i Kredive

Regjistri i Kredive vë në dispozicion të pjesëmarrësve të sistemit të Regjistrit të Kredive, informacionin e nevojshëm për të gjykuar drejt dhe shpejt mbi aftësitë shlyerëse të aplikuesit për kredi. Kjo